



Programma  
di cooperazione  
di comunità  
Trentino-Balcani  
2018-20



## Raport përmbledhës mbi workshopin:

### Prezantim i manualit

#### "Ndërmarrjet sociale në Shqipëri - Rregullimet ligjore dhe sfidat praktike"

Workshop-i për prezantimin e manualit "Ndërmarrjet sociale në Shqipëri - Rregullimet ligjore dhe sfidat praktike" realizuar në platformën online Zoom me datën 16.10.2020 në kuadër të projektit Ndërmarrjet Sociale në Shqipëri, financuar nga Programi Cooperazione e Sviluppo Trentino Balcani 2018.

Ashtu siç vjen qartë nga titulli i workshopit në thelb të këtij takimi ishin ndërmarrjet sociale, sfidat ligjore dhe praktike.

Foles në këtë takim të rëndësishëm me pjesëmarrjen e më shumë se 35 organizatave nga e gjithë Shqipëria ishin: Znj. Merita Xhafa, Drejtore e Përgjithshme, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; znj. Aida Gugu eksperte e angazhuar për hartimin e manualit.

Në takim morën pjesë shumë drejtues të Organizatave të Shoqërisë Civile nga e gjithë Shqipëria, përfaqësues të Sherbimit Social Shtetërorë dhe specialist të fushës sociale.

Takimin e hapoi z. Marjan Lukani drejtues i Acli Ipsia në Shqipëri, i cili bëri prezantimin e kësaj nisme dhe rëndësinë e këtij takimi në nivele gjithëpërfshirëse.

Gjate fjalës së tij z. Lukani paraqiti nevojën që ofron përditësimi i kuadrit ligjor për Ndërmarrjet Sociale dhe sidomos përmirësimi dhe plotësimi i akteve nenligjore. Gjate fjalës së tij z. Lukani falenderoi për pjesëmarrjen në këtë takim të znj. Merita Xhafa Drejtore e Përgjithshme e Politikave Sociale në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e cila po jep një kontribut shumë të vlefshëm në hartimin dhe zbatimin e paketës ligjore për ndërmarrjet sociale.

Në fillim u prezantua historiku i kësaj nisme që në vitet 2003 nga rajoni i Emilia Romagna si një vend me eksperiencë shumë pozitive në këtë drejtim, deri në vitet 2010 ku kjo nisme filloi të marrte hapësirë dhe vëmendjen e nevojshme për të marrë hapa e duhur deri në formulimin e ligjit në 65/2016.

Gjate prezantimit eshte theksuar domosdoshmeria per intensifikimin e punes nga strukturat politikeberese per ta plotesuar kete kuader ligjore me aktet normative dhe permiresimet e nevojshme qe dalin nga puna dhe nevojat e organizatave qe operojne me modelin e nderrmarrjeve sociale.

Pas fjales hyrese te z. Lukani, znj Merita Xhafa prezantoi punen e Ministrise se Shendetsesise dhe Mbrojtjes Sociale per paketen e akteve nenligjore qe jane duke pregatitur.

Znj Merita u ndal shume ne rolin qe kane nderrmarrjet sociale ne zhvillimin ekonomik-social ne teresi, gjithashtu u theksua rendesia e ketyre nderrmarrjeve per te rritur numrin e te punesuarve nga shtresat vulnerable.

Hapi dyte dhe shume i rendesishem, pervec aspektit ligjor, eshte edhe aspekti financiare dhe per ta theksuar kete aspekt, znj. Xhafa beri present punene dhe kontributin e vazhdueshem te Ministrise per **financimin e bizneseve sociale**.

Ajo theksoi se perfitues te ketyre financimeve jane ato biznese sociale qe kane marre statusin dhe plotesojne kriteret e percaktuara dhe kane nje plan biznes te mire detajuar.

Gjithashtu u prezantua puna qe po ben Ministria per hartimin e strategjive afatmesme dhe afatgjata per Mbrojtjen Sociale, per integrimin e PAK, per viktimat e dhunes ne familje etj.

Moderatori i ketij takimi, z. Lukani vleresoi shume punen e Ministrise nder vite dhe falenderoi ne vecanti znj. Xhafa si nje mbeshtetese e palodhur per funksionimin dhe zhvillimin e nderrmarrjeve sociale.

Me pas fjala ju kalua znj. Aida Gugu (Bushati), eksperte e kontraktuar nga Acli Ipsia ne Shqiperi, per te hartuar manualin “Ndermarrjet sociale ne Shqiperi, Sfidat Ligjore dhe praktike”. Znj. Gugu (Bushati), ka punuar qe ne vitin 2010 per kuadrin ligjor te ndermarrjeve sociale, fushe qe ajo e njeh shume mire, qe pasqyrohet me se miri dhe tek manuali qe prezantoi gjate takimit.

Ne fillim te prezantimit znj. Gugu (Bushati) u ndal ne pikat kryesore qe do trajtonte gjate takimit:

1 Perkufizimin e Ndermarrjeve Sociale

2 Financimin dhe Taksat

3 Raportimi



Programma  
di cooperazione  
di comunità  
Trentino-Balcani  
2018-20



#### 4 Likujdimi dhe Monitorimi

Gjate prezantimit te draft manualit, znj. Gugu (Bushati), theksoi rendesine e nxitjes te ideve te reja, mbeshtetjes se shtresave ne nevoje, integrimin ne pune te kategorive te disavantazuara dhe aksesin ndaj sherbimeve qe territori ofron.

Gjate prezantimit u theksua se vizioni i nje biznesi social duhet te shkoje pertej sherbimeve bazike. Ajo ndau me te pranishmit ne takim edhe kuadrin ligjore qe ndihmon ne krijimin dhe funksionimin e nderrmarrjeve sociale si

Ligji 65/2016

Ligji 8788

Vendimet 16/2018, vendimi 56/2018, vendimi 789/2018 .

Me tej ne forme edhe te bashkebisedimi u diskutua mbi dy format e nderrmarrjeve sociale

- Ate te kufizimit per sherbime vetem per grupet e pafavorizuara apo
- te krijimit te cdo sherbimi qe i sherben komunitetit

Me pjesemarresit u nda rendesia e **Qellimit** qe do kete punesimi, ofrimi i mallrave dhe sherbimeve si dhe integrimi social.

Po kaq i rendesishem sa qellimi jane edhe **Parimet** si Transparenca, Qendrueshmeria, Autonomia dhe llogaridhenia , Dimensioni kolektiv dhe Efektiviteti.

Znj Gugu shpjegoi gjithashtu krijimin e Fondit te nderrmarrjeve sociale edhe skemen e ndihmes shteterore qe iu eshte ne dispozicion. Takimi ishte interaktiv dhe pjesemarresit gjate prezantimit e nderprene disa here znj. Gugu, me pyetje, sakesime apo diskutime.

Ndersa nje pyetje e rendesishme qe znj. Gugu (Bushati) i drejtoi pjesemarresve ishte

A jane te mjaftueshme lehtesirat fiskale dhe jo fiskale qe ofron ligji per funksionimin e nderrmarrjeve sociale?

Pergjigjia e pjeses me te madhe te pjesemarresive ishte qe **JO, dhe pare nga ky aspekt** veshtireson funksionin e nderrmarrjeve sociale.



Programma  
di cooperazione  
di comunità  
Trentino-Balcani  
2018-20



Ne kete pike te diskutimit nga perfaqesuesja e Agjencise se Zhvillimit Ekonomik Lokal Auleda, Vlore, znj. Mirela Koci ndau eksperiencen positive te vendeve fqinje si Greqia ku lehtesite fiskale per bizneset sociale jane te shumta.

Gjithashtu znj. Klotilda Kosta nga Partners Albania diskutoi mbi rendesine qe kane zhvillimi i aktiviteteve te ndryshme nga OJF qe duan te marrin statusin e Ndermarrjeve Sociale.

Aktivitetet mund te jene nga fusha e sherbimeve shoqerore, sherbime shendetesore, sherbime ne mjedis, ne turizem, kualifikim dhe nxitje punesimi ne menyre qe te mos kufizohemi vetem me sherbime fikse, theksoi znj. Kosta.

Ne vijim te workshopit u diskutua per raportin ne % qe duhet te kete nr i pergjitheshem I te punesuarve me ate te grupeve vulnerable, kjo u ilustrua edhe me shembuj.

Nje vend te rendesishem ne diskutim moren procedurat per rregjistrimin e Bisnesit social:

- 1 Paraqitja e kerkeses prane MSHMS
- 2 Plotesimi I kriterëve ekonomike dhe kriterëve sociale
- 3 Pershkrimi I detajuar i fushes se veprimit dhe aktiviteteve konkrete
- 4 Pregatitja e nje plan biznesi te qarte dhe te detajuar

Edhe gjate ketij diskutimi znj Mirela Koci, perfaqesuese e Auleda, Vlore dha mendimin e saj se per funksionimin me te mire te bizneseve sociale dhe theksoi qe duhet ti jepet prioritet qendrushmerise se sherbimeve te nevojshme per komunitetin dhe me pas punesimin e shteresave vulnerable kjo edhe ne llojin e sherbimit qe bizneset sociale ofrojne.

Ne nderhyrjen e saj ne kete pjese te diskutimit, znj. Merita Xhafa theksoi edhe rendesine qe ka zbatimi i rregullores tip qe eshte hartuar nga Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale.

Me vone ne nderhyrjen e tij te fundit z. Lukani propozoi krijimin e nje Forumi me OJF per Ndermarrjen Sociale , forum nga i cili do te dalin sugjerime qe OJF propozojne prane Ministrise se Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale per lehtesimin dhe funksionimin e ketyre bizneseve sociale, kjo ne funksion te zhvillimit social-ekonomik dhe permiresimit te realitetit.

Perfaqesuesit e OJF falenderuan per organizimin e ketij takimi shume te vlefshem per materialet dhe eksperiencat qe u ndane mes njeri-tjetrit.



Programma  
di cooperazione  
di comunità  
Trentino-Balcani  
2018-20



Gjithashtu ne fund te takimit znj. Merita Xhafa shprehu gatishmerise e Ministrise se Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale per vazhdimin e punes nga ana e tyre per lehtesimin dhe mirefunksionimin e cdo procedure per Ndermarrjen Sociale.